

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 31

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për menaxhimin dhe ortakët e Crimson Finance Fund Albania Sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Crimson Finance Fund Albania Sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

19 mars 2018



Teit Gjini
Auditor Ligjor
MAZARS
Rr. Emin Duraku Pal. Binjaket
No.5, 1000 TIRANA, ALBANIA
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al info@mazars.al

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	5	3,349,739	1,932,303
Totali i aktiveve afatgjatë		3,349,739	1,932,303
Aktivët afatshkurtra			
Huadhënie dhe paradhënie (Faktoring), neto	6	50,319,825	24,308,127
Investimi në qera financiare, neto	7	46,917,316	17,118,622
TVSH e arkëtueshme	8	10,208,498	4,233,016
Llogari të arkëtueshme të tjera	9	9,090,558	514,987
Mjetet monetare në arkë e në bankë	10	130,973,912	71,181,872
Totali i aktiveve afatshkurtra		247,510,109	117,356,624
Totali i aktiveve		250,859,848	119,288,927
KAPITALI			
Kapitali nënshkruar		55,000,000	55,000,000
Kapitali nënshkruar i papaguar		(260,240)	(260,240)
Humbje të mbartura		(4,420,566)	(1,010,377)
Humbja e ushtrimit		(8,361,308)	(3,410,189)
Totali i kapitalit	11	41,957,886	50,319,194
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Borxh i varur	12	206,051,584	67,831,000
Totali i detyrimeve afatgjatë		206,051,584	67,831,000
Detyrime afatshkurtra			
Interesa të pagueshme	12	1,935,712	205,050
Llogari të pagueshme tregtare	13	288,189	384,353
Parapagimet e arkëtuara	14	100,829	74,553
Detyrime tatimore	15	525,648	393,777
Llogari të pagueshme të tjera	16	-	81,000
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,850,378	1,138,733
Totali i detyrimeve		208,901,962	68,969,733
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		250,859,848	119,288,927

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7-31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	17	13,564,992	2,575,188
Shpenzime për interesa	18	(2,712,263)	(651,567)
Të ardhurat neto nga interesat		10,852,729	1,923,621
Të ardhura nga grante	19	-	10,415,504
Të ardhura të tjera	20	507,500	379,060
Fitim /(Humbje) nga këmbimet valutore	21	(9,787)	(135,727)
Të ardhurat të tjera operative		497,713	10,658,837
Zhvlërimi neto i qerave financiare, huave dhe paradhënie faktoring	22	(2,260,137)	(615,183)
Shpenzime personeli	23	(10,877,348)	(7,388,464)
Shpenzime amortizimi	24	(823,178)	(553,166)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(5,751,087)	(7,435,834)
Total shpenzime		(19,711,750)	(15,992,647)
Fitimi/humbja para tatimit		(8,361,308)	(3,410,189)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	26	-	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(8,361,308)	(3,410,189)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(8,361,308)	(3,410,189)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7-31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Kapitali nënshkruar i papaguar	Humbjet e mbartura	Fitim / (Humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	55.000.000	(260.240)	-	(1.010.377)	53.729.383
Transferim në humbje të mbartura			(1.010.377)	1.010.377	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				(3.410.189)	(3.410.189)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	55.000.000	(260.240)	(1.010.377)	(3.410.189)	50.319.194
Transferim në humbje të mbartura			(3.410.189)	3.410.189	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				(8.361.308)	(8.361.308)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	55.000.000	(260.240)	(4.420.566)	(8.361.308)	41.957.886

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7-31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori më ____ mars 2018 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Z. Dorin Rama
Hartuesi i pasqyrave financiare


Z. Eugen Liçi
Administrator

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(8,361,308)	(3,410,189)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	823,178	553,166
Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve	2,260,137	615,183
Tatimi mbi fitimin		
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues :</i>		
Rënie/(rritje) në qira financiare dhe hua dhënë klientëve	(58,070,529)	(62,041,932)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(14,251,053)	(3,977,066)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	1,711,645	(2,113,778)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(75,887,930)	(50,374,616)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(300,000)	(30,000)
	(300,000)	(30,000)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(2,240,614)	(59,140)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(2,240,614)	(59,140)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	138,220,584	67,831,000
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	138,220,584	67,831,000
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	59,792,040	17,367,244
Mjetet monetare në fillim të periudhës	71,181,872	53,814,628
Mjetet monetare në fund të periudhës	130,973,912	71,181,872

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7-31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k është një institucion financiar jo-bankë i themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar më datë 07/01/2015 pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në bazë të ligjit përkatës në fuqi.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 datë 14/04/2008, "Për shoqëritë tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18/12/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 8269, datë 23/12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendim nr. 01, datë 17/01/2013 të Këshillit Mbikëqyres, Crimson Finance Fund Albania sh.p.k ka marrë licencën (nr. 34) më datë 02/10/2015 për ushtrimin e aktivitetit të saj si subjekt financiar jobankë. Aktiviteti normal i shoqërisë ka filluar në këtë datë. NIPT-i i shoqërisë është L51307031A.

Objekti i aktivitetit të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k. i paraqitur pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Bankës së Shqipërisë është si vijon:

"Aktivitet i faktoringut /financim nëpërmjet urdhër blerjes, qira financiare, garanci dhe konsulentë, ndërmjetësim, si dhe shërbime të tjera financiare ndihmëse, asistencë teknike dhe trajnim për tregtarët, fermerët, dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri".

Më datë 31/12/2017 Crimson Finance Fund Albania operon në Tiranë dhe numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 8 punonjës(2016:5 punonjës).

Adresa e regjistruar e zyrave qendrore të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k. ndodhet në rrugën Bardhok Biba, Godina e Vjetër Tirana, Hyrja 1, Katë 2, Tiranë, Shqipëri.

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF).

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standarde të publikuara që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe nuk janë adoptuar ende

Standardet e publikuara por që nuk kanë hyrë në fuqi në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë të listuara më poshtë. Ky është një listim i standardeve dhe interpretimeve të publikuara, të cilat Shoqëria në mënyrë të arsyeshme pret të jenë të aplikueshme në një datë të ardhshme. Shoqëria pret të adoptojë këto standarde kur ato të hyjnë në fuqi.

• SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershëm. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi nuk ka vlerësuar ndikimin dhe impaktin që do të ketë aplikimi i këtij standardi.

• SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë. KIRFN 4 përcakton nëse një marrëveshje përmban një marrëveshje qiraje. KIS-15 Qerata Operative- Nxijtjet dhe KIS 27 Vlerësimi i Përbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e qirave. Gjithashtu kërkon nga qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë në një model të vetëm në bilancin e gjendjes të ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy sqarime për qiratë- qiraja "me vlerë të ulët" (p.sh. kompjuter), dhe qiraja "afat-shkurtër" (qiratë me afat 12 muaj ose më pak). Në ditën e marrëveshjes për qira, qiramarrësi do të njohë detyrimin për pagesë të qirasë (detyrimi për qira) dhe një pasuri që paraqet të drejtën për shfrytëzimin e qirasë për periudhën kohore të përcaktuar në kontratë (p.sh.,e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësit do t'i kërkojë të njohë veçmas shpenzimet e interesit mbi qiranë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

• **SNRF 16 Qiratë (Vazhdim)**

Qiramarrësi do të duhet të rimatë detyrimin e qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë që përdoret për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rimatjes së detyrimit të qirasë si një rregullim për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

SNRF 16 kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të bëjnë shpalosje më të gjërë se sa SNK 17.

SNRF 16 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019. Aplikimi i hershëm është i lejuar, por jo para se njësi ekonomike të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të zgjedh për të aplikuar standardin duke përdorur ose një retrospektivë të plotë apo një qasje të modifikuar retrospektivë.

Dispozitat kalimtare të standardit lejojnë disa lehtësira të caktuara.

• **SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e ltuara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimitarise të zakonshme të njesisë ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata material dhe jo-materiale). Dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në llogaritjen e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe vlerësimet. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin që standardi do të ketë në pasqyrat financiare, megjithatë nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm.

• **SNK 7 Iniciativa e Shpalosjes - Ndryshimet në SNK 7**

Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme janë pjesë e iniciativës të BSNK-së për shpalosje dhe kërkojnë që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese që i mundësojnë përdoruesit të pasqyrave financiare të vlerësojë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare, duke përfshirë të dy ndryshimet që rrjedhin nga flukset e parave të gatshme dhe ndryshimet nga paratë jo të gatshme. Në aplikimin fillestar të ndryshimit, subjektet nuk janë të detyruara të sigurojnë informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017, me aplikimin e hershëm të lejuar.

3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, rrumbullakosur në Lekun më të afërt.

3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

3.2 Paraqitja e pasqyrave financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

3.3 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

3.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të shoqërisë, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimi më i rëndësishëm i gjykimeve dhe vlerësimeve është si vijon:

3.4.1 Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Shoqëria rishikon portofolet e saj të qirave financiare dhe hua dhe paradhënie faktoring në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrotueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol huaje para se rënia të mund të identifikohet me një hua dhe paradhënie individuale në këtë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrotueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësit, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e qirasë financiare ose huamarrjes faktoring nga huamarrësit.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare:

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në datën e raportimit të shprehura në monedhë të huaj rivelesohen në Lek me kursin në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet dhe detyrimet jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj, rivelesohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja neto nga ndryshimi i kurseve të këmbimit paraqitet në zërin "Fitimi/(humbje) neto nga këmbimet valutore" në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse.

Kursi i këmbimit të aplikuar (nga LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore në fund viti më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 ka qenë si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/Lek	111.10	128.17

4.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

a) Investime në qira financiare, neto

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Interesi efektiv në rastin e instrumentave të Shoqërisë ndryshon nga ai nominal vetëm për komisionin e disbursimit që aplikohet vetëm në momentin fillestar të dhënies së qirave financiare. Të ardhurat e interesit llogariten fillimisht me normën nominale të interesit ndërsa komisioni i disbursimit, që është pjesë e normës efektive të interesit, njihet progresivisht si e ardhur në mënyrë lineare përgjatë afatit të financimit. Në këtë mënyrë, metoda e njohjes së të ardhurave nga interesi nuk ndryshon në mënyrë materiale nga metoda e interesit efektiv.

b) Hua dhe paradhënie, faktoring

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Interesi efektiv në rastin e instrumentave të Shoqërisë ndryshon nga ai nominal vetëm për komisionin e disbursimit që aplikohet vetëm në momentin fillestar të dhënies së huasë faktoring. Të ardhurat e interesit llogariten fillimisht me normën nominale të interesit ndërsa komisioni i disbursimit, që është pjesë e normës efektive të interesit, njihet progresivisht si e ardhur në mënyrë lineare përgjatë afatit të financimit. Në këtë mënyrë, metoda e njohjes së të ardhurave nga interesi nuk ndryshon në mënyrë materiale nga metoda e interesit efektiv.

4.3 Pagesat e qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Shoqëria si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë tek shoqëria në mënyrë thelbësore të gjitha rreziket dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operationale. Pagesat e qirasë operationale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.3 Pagesat e qirasë (vazhdim)

Shoqëria si një qiradhënës (qira financiare)

Qiratë ku shoqëria transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si investim neto në qira financiare. Fillimi i qirasë është data e disbursimit të fondeve. Në këtë datë:

- një qira klasifikohet si qira financiare dhe;
- përcaktohen shumat që do të njihen me fillimin e afatit të qirasë.

Fillimi i qirasë është data në të cilën qiramarrësi ka të drejtë të përdorë aktivin e blerë me qira financiare. Kjo është data e njohjes fillestare të qirasë (p.sh. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë nga investimi neto në qira financiare, sipas rastit). Në pasqyrën e pozicionit financiar, Shoqëria paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare neto. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara. Të ardhurat nga investimi neto në qira financiare të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të qirasë financiare janë vlera e drejtë e aktivit, ose nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut. Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e investimit neto në qira financiare, duke përdorur politikat e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. qiratë financiare, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se kredite dhe investimi neto në qira financiare kanë karakteristikë të ngjashme rreziku.

4.4 Hua dhe paradhënie, faktoring

Kontratat Faktoring, të cilat rregullohen në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006, "Për Faktoringun", përmbajnë 3 palë: Faktorin, Furnizuesin dhe Debitorin, të përshkruara shprehimisht në këtë ligj.

Shoqëria si një faktor

Hua-të dhe paradhënie faktoring përfaqësohen nga dy nënprodukte financiare të ofruara nga Shoqëria, për të cilat kjo e fundit përfaqëson në të dyja rastet faktorin.

- Faktoring-u i drejtpërdrejtë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të shitjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Furnizuesi luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Gjithashtu, në rast mos-shlyerje të vlerës së principalit nga ana e debitorit, furnizuesi mbetet debitor/garant edhe për shumën e principalit të financuar nga faktori, e cila e ben këtë formë faktoring-u "me garanci".
- Faktoring-u i anasjelltë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të blerjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Debitori luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Në këtë formë faktoring-u, furnizuesi bëhet pjesë e kontratës së faktoring-ut me qëllim transferimin e të drejtave të faturave të financuara, nga furnizuesi tek faktori. Debitori mbetet përgjegjës për rikthimin e vlerës së faturave të financuara në përfundim të afatit të kontratës faktoring.

Shoqëria përllogarit dhe bën të pagueshëm një interes fiks nominal mbi balancën mujore të papaguar që përbëhet nga shuma e faturave të financuara. Ripagesa e principalit bëhet e kërkueshme në përfundim të afatit të kontratës faktoring.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5 Tatimet (vazhdim)

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

a. Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të pazbritshëm.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

b. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivitetet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shihet ose aktiviteti realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhjet tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 shoqëria nuk ka aktiv ose detyrim tatimor të shtyrë.

c. TVSH e arkëtueshme

Në bazë të nenit 71 të Ligjit nr. 92 datë 27.04.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", shoqëritë me "aktivitet miks" si taksapagues që kanë aktivitete të cilat janë subjekt të TVSH-së dhe rrjedhimisht kanë TVSH të zbritshme, si dhe aktivitete që janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Këta subjekte mund ta zbresin TVSH-në në blerje që u shërbejnë të dyja aktiviteteve, si një përqindje (proporcionalisht) mbi volumin e aktivitetit të tatueshëm. Ndërsa përsa i përket blerjeve që u shërbejnë vetëm aktivitetit të tatueshëm, TVSH-ja e tyre është plotësisht e zbritshme dhe anasjelltas.

Metoda e llogaritjes së koeficientit të zbritjes së TVSH-së detajohet në nenin 72 të Ligjit mbi TVSH-në, sipas së cilët theksohet se ky koeficient llogaritet nga raporti i mëposhtëm:

- në numërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet që sjellin të drejtën e zbritjes
- në emërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet e përfshira në numërues dhe me transaksionet që nuk sjellin të drejtën e zbritjes.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Tatimet (vazhdim)

c. TVSH e arkëtueshme (vazhdim)

Koeficienti i zbritjes së TVSH-së përcaktohet mbi bazë vjetore; koeficienti i zbritjes së TVSH-së e aplikueshme provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm (ose përlllogaritet për vitin e parë të aktivitetit mik). Pas fundit të vitit, taksapaguesi duhet të llogarisë koeficientin e zbritjes së TVSH-së dhe të rregullojë në mënyrë prospektive TVSH-në e arkëtueshme bazuar në këte koeficient. Shoqëria ka llogaritur koeficientin e zbritjes së TVSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe ka rregulluar TVSH e arkëtueshme nga aktivite të tjera përveç qirasë financiare.

4.6 Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

a. Data e njohjes

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

b. Matja fillestare e instrumentave financiarë

Shoqëria fillimisht njihë huatë dhe paradhëniet e dhëna klienteve, depozitat, huatë e marra në datën kur ato janë krijuar.

Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën shoqëria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare.

Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

c. Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivët financiarë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalentë
- Hua dhe paradhënie për faktoring
- Investimi neto në qira financiare

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe ç'rregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brënda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

d. Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emtuar nga shoqëria janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e shoqërisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emtuara nga shoqëria janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6 Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

e. Investime në qira financiare dhe faktoring

Hua dhe paradhënie për klientët (përfshirë qiratë financiare dhe faktoring) përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që shoqëria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që shoqëria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që shoqëria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që shoqëria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënieve për klientët janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit nominal. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, shitjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivit apo detyrimit financiar. Të ardhurat apo shpenzimet e interesit të përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizueshme me një normë interesi nominal.

4.7 Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur shoqëria ka të drejtën tregore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të shoqërisë.

4.8 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e instrumentit financiar përcaktohet si çmimi që do të përfitohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, shoqëria kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë të matur me vlerën e drejtë.

Për qëllime dhënieje të informacioneve shpjeguese në lidhje me vlerën e drejtë, shoqëria ka përdorur modele vlerësimi aty ku ka të dhëna të observueshme tregu; nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, atëherë shoqëria ka përdorur gjykimin e saj në përcaktimin e vlerave të drejta të instrumentave financiarë.

Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.9 Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivitet monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitet monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

4.10 Aktive afatgjata materiale

a. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitet në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes, kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

b. Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen shoqëria do të këtë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse.

c. Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitet përveçse për aktivitet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivitet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitet. Toka nuk zhvlerësohet. Metodot e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	Jetëgjatësia	Amortizimi (%)
Pajisje elektronike dhe kompjutera	4 vite	25%
Pajisje zyre	5 vite	20%
Mjete transporti	5 vite	20%

4.11 Borxhi i varur

Huamarrjet nga ortakët janë burimet kryesore të financimit të shoqërisë. Huamarrjet nga ortakët maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me koston të amortizuar, përveçse në rastet kur shoqëria zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.

Shoqëria ka borxh të varur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 me disa nga ortakët e saj. Në bazë të kontratave të borxhit të varur, shumat e huave behën të disponueshme për shoqërinë në bazë të kërkesave me shkrim nga kjo e fundit për shumën dhe datën e kërkuar të disbursimit. Më pas, çdo transh i disbursuar ripaguhet me një kalendar të vecantë amortizimi. Interesat paguhen 4 herë përgjatë vitit dhe përllëgariten çdo muaj nga shoqëria.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.12 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Organet publike shtetërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

Shoqëria gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në shoqëri nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

5. Aktivët afatgjatë materiale

	Mobilje e pajisje zyre	Mjete transporti	Pajisje informatike	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2016	1,286,841	-	1,260,776	2,547,617
Shtesa			59,140	59,140
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,286,841	-	1,319,916	2,606,757
Shtesa	214,468	2,026,146		2,240,614
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,501,309	2,026,146	1,319,916	4,847,371
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2016	47,887		73,401	121,288
Amortizimi i vitit	256,322		296,844	553,166
Kthim amortizimi				-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	304,209	-	370,245	674,454
Amortizimi i vitit	229,086	371,459	222,633	823,178
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	533,295	371,459	592,878	1,497,632
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2016	982,632	-	949,671	1,932,303
Gjendja më 31 dhjetor 2017	968,014	1,654,687	727,038	3,349,739

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

6. Huadhënie dhe paradhënie (Faktoring) neto

Huat dhe paradhëniet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua dhe paradhënie, Faktoring	51,859,783	24,760,756
Interes i përlogaritur	451,833	158,563
Komisione të papërfituara	(566,987)	(362,003)
Zhvlerësimi i huave të dhëna	(1,424,804)	(249,189)
	<u>50,319,825</u>	<u>24,308,127</u>

Lëvizjet në fondin rezervë për mbulimin e humbjeve

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja më 1 janar	249,189	-
Zhvlerësimi për vitin	1,175,615	249,189
Gjendja më 31 dhjetor	<u>1,424,804</u>	<u>249,189</u>

7. Investime në qera financiare

Investimet në qera financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Investimi në qira financiare, bruto	60,378,274	22,674,025
Interes i përlogaritur	425,877	99,821
Të ardhurat e papërfituara nga Interesi	(11,332,038)	(4,880,558)
Komisione të papërfituara	(1,104,280)	(408,671)
Zhvlerësimi huave të dhëna	(1,450,517)	(365,995)
	<u>46,917,316</u>	<u>17,118,622</u>

Lëvizjet në fondin rezervë për mbulimin e humbjeve

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja më 1 janar	365,995	-
Zhvlerësimi për vitin	1,084,522	365,995
Gjendja më 31 dhjetor	<u>1,450,517</u>	<u>365,995</u>

8. TVSH e arkëtueshme

TVSH e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH e arkëtueshme nga qiraja financiare	9,430,047	3,527,483
TVSH e arkëtueshme nga aktivitet e tjera	778,451	705,533
	<u>10,208,498</u>	<u>4,233,016</u>

9. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura të përlogaritura	-	362,500
Shpenzime të shtyra	169,921	96,687
Tatim fitimi i parapaguar	330,000	30,000
Depozita garancie	79,964	25,800
Të tjera të arkëtueshme	8,510,673	-
	<u>9,090,558</u>	<u>514,987</u>

10. Mjete monetare në arkë dhe në bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	130,960,491	71,169,100
Në lekë	23,165,540	9,873,717
Në monedhë	107,794,951	61,295,383
Mjete monetare në arkë në lekë	13,421	12,772
	<u>130,973,912</u>	<u>71,181,872</u>

11. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Numri i kuotave	4	4
Vlera e një kuote	13,750,000	13,750,000
	<u>55,000,000</u>	<u>55,000,000</u>

Ortakët e shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Albanian –American Development Fund zotëron 25% të vlerës së kapitalit ose 13,750,000 lekë
- Crimson Capital Corp zotëron 25% të vlerës së kapitalit ose 13,750,000 lekë
- NORFUND zotëron 25% të vlerës së kapitalit ose 13,750,000 lekë
- Bashkia Tiranë zotëron 25% të vlerës së kapitalit ose 13,750,000 lekë

Vlera e kapitalit të nënshkruar të papaguar nga Crimson Capital Corp më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është 260,240 lekë.

Humbjet e mbartura të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 janë (4,420,566) Lekë (2016: (1,010,377) Lekë).

Humbja e ushtrimit më 31 dhjetor 2017 është (8,361,308) lekë (2016: (3,410,189) Lekë).

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
 Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

12. Borxh i varur

	Limiti financimit	Disbursuar	Monedha	Dt. e		Interesi	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
				fillimit	maturimit		LEK	LEK	LEK	LEK
Fondi Shqiptaro- Amerikan i Zhvillimit	822,000						87,417,284		27,046,000	
Transhi i parë	100,000	EUR		13-05-16	13-05-21	2.25%	13,295,000		13,523,000	
Transhi i dytë	100,000	EUR		22-12-16	30-06-21	2.25%	13,295,000		13,523,000	
Transhi i tretë	100,000	EUR		14-06-17	30-06-21	2.25%	13,295,000		-	
Transhi i katërt	193,200	EUR		29-08-17	30-06-21	2.25%	25,685,940		-	
Transhi i pestë	164,320	EUR		04-12-17	30-06-21	2.25%	21,846,344		-	
NORFUND	500,000						66,475,000		27,046,000	
Transhi i parë	100,000	EUR		19-07-16	30-06-21	2.25%	13,295,000		13,523,000	
Transhi i dytë	100,000	EUR		23-12-16	30-06-21	2.25%	13,295,000		13,523,000	
Transhi i tretë	100,000	EUR		19-06-17	30-06-21	2.25%	13,295,000			
Transhi i katërt	100,000	EUR		13-09-17	30-06-21	2.25%	13,295,000			
Transhi i pestë	100,000	EUR		20-12-17	30-06-21	2.25%	13,295,000			
Bashkia Tiranë	637,000						52,159,300		13,739,000	
Transhi i parë	13,739,000	ALL		08-01-16	08-01-21	2.25%	13,739,000		13,739,000	
Transhi i dytë	13,500,000	ALL		10-01-17	30-06-21	2.25%	13,500,000			
Transhi i tretë	13,700,000	ALL		18-04-17	30-06-21	2.25%	13,700,000			
Transhi i katërt	11,220,300	ALL		30-10-17	30-06-21	2.25%	11,220,300			
Totali	1,959,000						206,051,584		67,831,000	

Interesi është i barabartë me 2.25%+EURIBOR 3M, jo më pak se 2.25% dhe jo më shumë se 4.5%.

12. Borxh i varur (vazhdim)

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Interes i përlogaritur AADF	648,216	71,672
Interes i përlogaritur Norfund	681,052	69,190
Interes i përlogaritur Bashkia Tiranë	606,444	64,188
	<u>1,935,712</u>	<u>205,050</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme tregtare	57,451	384,353
Furnitorë për fatura të pambërritura	230,738	
	<u>288,189</u>	<u>384,353</u>

14. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime nga klientë	20,585	-
Të tjera detyrime	80,244	74,553
	<u>100,829</u>	<u>74,553</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	197,885	136,264
Detyrime për tatim mbi të ardhurat personale	291,258	220,404
Detyrime për tatim në burim	36,505	37,109
	<u>525,648</u>	<u>393,777</u>

16. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë të pagueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të përlogaritura	-	81,000
	<u>-</u>	<u>81,000</u>

17. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat e qirave financiare	5,179,323	1,375,060
Të ardhura nga interesat e faktoringut	5,299,086	856,156
Të ardhura nga komisionet e kamatëvonesat e qirave financiare	622,560	86,013
Të ardhura nga komisionet e kamatëvonesat e faktoringut	2,458,206	231,929
Të ardhura nga interesat prej veprimeve me institucionet bankare	5,817	26,030
	<u>13,564,992</u>	<u>2,575,188</u>

18. Shpenzimet për interesa

Shpenzimet për interesa detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesat e borxhit të varur	2,712,263	651,567
	<u>2,712,263</u>	<u>651,567</u>

19. Të ardhura nga grante

Të ardhurat nga grante detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga grantet	-	10,415,504
	<u>-</u>	<u>10,415,504</u>

20. Të ardhura të tjera

Të ardhurat të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga menaxhimi i projektit për Rivitalizimin e Pazarit të Korçës	507,500	362,500
Të ardhura të tjera	-	16,560
	<u>507,500</u>	<u>379,060</u>

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

21. Fitim/ (humbje) nga këmbimet valutore

Fitim/ (humbje) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitim nga këmbimet valutore	3,263,094	1,027,448
Humbje nga këmbimet valutore	(3,272,881)	(1,163,175)
	<u>(9,787)</u>	<u>(135,727)</u>

22. Zhvlerësimi neto i qerave financiare, huave, paradhënie

Zhvlerësimi i qerave financiare dhe paradhënieve faktoring për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Zhvlerësimi i huave të dhëna, faktoring	1,175,615	249,189
Zhvlerësimi i huave të dhëna, qira financiare	1,084,522	365,994
	<u>2,260,137</u>	<u>615,183</u>

23. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	9,787,757	6,697,543
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,089,591	690,921
	<u>10,877,348</u>	<u>7,388,464</u>

24. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi	823,178	553,166
	<u>823,178</u>	<u>553,166</u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime qiraje	2,936,557	2,721,430
Komisione ligjore dhe konsulence	319,340	2,103,295
Rregullimi i balances së TVSH për efekt të koeficientit të kreditimit	192,409	525,422
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	540,331	465,528
Shpenzime për automjete	437,205	364,827
Shërbime nga të tretë	353,075	292,369
Mirëmbajtje dhe riparime	239,403	206,388
Shpenzime marketingu	66,716	168,755
Artikuj zyre	69,326	125,548
Shpenzime sigurimi	87,668	123,101
Energji, uje	161,033	92,833
Komisione bankare	56,831	35,406
Taksa	9,200	12,977
Gjopa e dëmshperblime	993	20,895
Shpenzime udhëtimi	74,210	172,160
Të tjera shpenzime	206,790	4,900
	5,751,087	7,435,834

26. Tatim fitimi

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	(8,361,308)	(3,410,189)
Total shpenzime të panjohura	629,423	999,862
Shpenzime udhëtimi	-	-
Shpenzime të tjera	629,423	999,862
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(7,731,885)	(2,410,327)
Humbje fiskale e mbartur	(3,326,410)	(916,083)
Tatim fitimi @15%	-	-
	(8,361,308)	(3,410,189)

27. Transaksione me palët e lidhura

Në tabelat e mëposhtme, shoqëria prezanton marrëdhëniet që ekzistojnë midis saj dhe palëve të lidhura me të, natyrën e transaksioneve, vlerat përkatëse, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat deri më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016.

Drejtuesit e shoqërisë janë ata persona të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të saj, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, përfshirë këtu edhe drejtues ekzekutivë, ose jo, të lartë të shoqërisë. Palët e tjera të lidhura të shoqërisë, që mund të jenë individë të lidhur me shoqërinë ose pjesëtarë të ngushtë të familjes së këtyre individëve, që kanë kontroll të plotë ose të përbashkët nga individët e lidhur me shoqërisë apo pjesëtarë të ngushtë të familjes së tyre, apo që kanë influencë të konsiderueshme mbi një entitet, prezantohen si Palë të tjera të lidhura të shoqërisë.

(Vlerat janë në Lek)

27. Transaksione me palët e lidhura (vazhdim)**Transaksionet me palët e lidhura**

Transaksionet	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Drejtuesit e shoqërisë	Palë të tjera të lidhura	Drejtuesit e shoqërisë	Palë të tjera të lidhura
Të ardhura		507,500	-	-
Shpenzime	4,125,319	2,712,263	5,174,840	651,567
Borxh i varur		206,051,584	-	67,831,000

Për më tepër, pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqitet si më poshtë:

	Pagal	Bonuset
Viti i mbylltur më 31 dhjetor 2017		
Shpërblimi i drejtimin të shoqërisë	3,573,019	552,300
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	-	-
Viti i mbylltur më 31 dhjetor 2016		
Shpërblimi i drejtimin të shoqërisë	4,525,066	649,774
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	-	-

28. Menaxhimi i rrezikut financiar**Hyrje dhe të përgjithshme**

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- risku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut si dhe administrimin e saj.

28.1 Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut për Crimson Finance Fund Albania. Bordi Drejtues përbëhet nga 4 anëtarë, të cilët janë edhe ortakët e Shoqërisë.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga shoqëria, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar përputhjen me kufizimet.

Crimson Finance Fund Albania, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

28. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
 28.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare i shoqërisë nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga qiratë financiare dhe hua dhe paradhënie faktoring. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, shoqëria konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Aprovimi i qirave financiare dhe huave faktoring miratohet fillimisht nga komiteti drejtues dhe më pas bordi drejtues.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë i aktiveve financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare (pa përfshirë paratë në dorë)	130,960,491	71,169,100
Hua dhe paradhënie (Faktoring)	51,744,629	24,557,316
Investime në qera financiare neto	48,367,833	17,484,617
TVSH e arkëtueshme	10,208,498	4,233,016
Aktive të tjera	8,590,637	388,300
Totali	249,872,088	117,832,349
Angazhime të kreditimit të padisbursuara	-	-
Totali angazhimeve të lidhura me kreditë	-	-
Rreziku kreditit	249,872,088	117,832,349

Ekspozimet e huave dhe paradhënieve faktoring dhe qira financiare të ndara sipas moshës, për periudhën deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Faktoring		
1-30 ditë Standarde	49,333,729	24,557,316
31-60 ditë Në ndjekje	-	-
61-90 ditë Nënstandarde	1,023,522	-
91-179 ditë Të dyshimta	1,387,378	-
>180 ditë Të humbura	-	-
	51,744,629	24,557,316
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Qira financiare neto		
1-30 ditë Standarde	37,944,435	14,366,264
31-60 ditë Në ndjekje	7,377,294	3,118,353
61-90 ditë Nënstandarde	3,046,104	-
91-179 ditë Të dyshimta	-	-
>180 ditë Të humbura	-	-
	48,367,833	17,484,617

28. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**28.2 Rreziku i kredisë (vazhdim)****Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim)**

Tabelat më poshtë paraqesin klasifikimin për huatë dhe paradhëniet faktoring dhe qira financiare sipas kategorive të klientëve për vitin deri me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016. Klasifikimi i përdorur nga shoqëria bazohet në ditëvonesat e qirave financiare dhe hua dhe paradhënie faktoring.

Vlerat e paraqitura më poshtë janë bruto, pa përfshirë zhvlerësimet përkatëse. Nuk ka investime në qira financiare dhe faktoring për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Shoqëria mban kolateral ndaj kredive dhe paradhënieve të klientëve në formën pengut të pasurisë, siguri të tjera të regjistruara ndaj aktiveve dhe garanci, shiko shënimin 20. Një analizë sipas përqendrimit të rrezikut të kredisë sipas sektoreve të industrisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Faktoring	Qira financiare	Faktoring	Qira financiare
Bujqësia, gjuetia, silvikultura		4,194,004		5,251,213
Ndërtim	7,973,010			
Industri përpunuese	23,894,550	12,498,154	9,747,201	4,367,511
Hotele dhe restorante		3,651,733		2,250,855
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	7,877,438	25,886,643	5,253,071	5,615,038
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	6,891,104	2,137,299	2,964,511	
Arsimi			2,286,207	
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	5,108,527		1,352,312	
Të tjera			2,954,014	
Totali	51,744,629	48,367,833	24,557,316	17,484,617

28.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria nuk do të përmbushë në kohë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

a. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të riskojë të dëmtojë emrin e mirë. Bordi Drejtues rishikon vazhdimisht situatën e likuiditetit të Crimson Finance Fund Albania dhe bën rekomandimet përkatëse. Mënyrat kryesore të përdorura nga Crimson Finance Fund Albania për administrimin e riskut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i "gap-it" (hendetul) për periudha specifike.

b. Luhatshmëria në tregjet financiare globale dhe shqiptare

Vazhdimi i krizës financiare dhe ekonomike botërore ka ndikim midis të tjerash edhe mbi zvogëlimin e tregjeve kapitale, uljen e likuiditetit në sistemin bankar dhe në momente specifike, edhe në rritjen e interesit të kreditimit ndërbankar dhe luhatshmërinë e tregjeve të letrave me vlerë. Zhvillime të tjera jo të favorshme të krizës mund të ndikojnë negativisht mbi pozicionin financiar dhe likuiditetin e Crimson Finance Fund Albania. Shoqëria llogarit në baza tremujore raportin në vijim: aktivet likuide përmbi detyrimet afatshkurtra. Aktivet likuide përfshijnë parane dhe ekuivalentet me të, depozitat afatshkurtra me bankat.

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
 Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

28. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

28.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Detajet e raportit të aktiveve likuide kundrejt detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese paraqiten si vijon:

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare

	31 dhjetor 2017					Totali
	0-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite	
Aktivët financiarë						
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	130,973,912					130,973,912
Investime në qira financiare		808,433	332,682	47,276,718		48,367,833
Hua dhe paradhënie, faktoring	19,824,904	31,919,725				51,744,629
Te tjera aktive		19,299,056				19,299,056
Totali	150,798,816	52,027,214	332,682	47,226,718	-	250,385,431
Detyrimet financiare						
Hua	1,936,712			66,919,000	139,132,584	207,987,296
Detyrime të tjera	914,666					914,666
Totali	2,850,378	-	-	66,919,000	139,132,584	208,901,962
Rreziku likuiditetit me 31 dhjetor 2017	147,948,438	52,027,214	332,682	(19,692,282)	(139,132,584)	41,483,469
	31 dhjetor 2016					
	0-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
Aktivët financiarë						
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	71,181,872					71,181,872
Investime në qira financiare	1,682,341	1,524,790	2,921,742	11,355,744		17,484,617
Hua dhe paradhënie, faktoring	6,556,365	18,000,951				24,557,316
Te tjera aktive	4,621,316					4,621,316
Totali	84,041,894	19,525,741	2,921,742	11,355,744	-	117,845,121
Detyrimet financiare						
Hua	205,050				67,831,000	68,036,050
Detyrime të tjera	933,683					933,683
Totali	1,138,733	-	-	-	67,831,000	68,969,733
Rreziku likuiditetit me 31 dhjetor 2016	82,903,161	19,525,741	2,921,742	11,355,744	(67,831,000)	48,875,388

28. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**28.4 Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit dhe normat e kursit të këmbimit do të ndikojë në të ardhurat e Crimson Finance Fund Albania apo vlerën e instrumentave financiarë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Hendeku i maturitetit për monedhat kryesore përllogaritet dhe analizohet nga Crimson Finance Fund Albania mbi baza vjetore. Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Crimson Finance Fund Albania më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 mbi bazën e maturitetit të mbetur:

	31 dhjetor 2017		
	LEK	EUR	Totali
Aktivët financiarë			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	23,178,959	107,794,951	130,973,910
Investime në qira financiare	17,085,398	31,282,435	48,367,833
Hua dhe paradhënie, faktoring	33,606,163	18,138,466	51,744,629
Të tjera aktive	12,475,082	6,324,053	18,799,135
Totali	86,345,602	163,539,905	249,885,507
Detyrimet financiare			
Hua	52,765,744	155,221,552	207,987,296
Detyrime të tjera	867,228	47,438	914,666
Totali	53,632,972	155,268,990	208,901,962
Rreziku monedhës më 31 dhjetor 2017	32,712,630	8,270,915	40,983,545
	31 dhjetor 2016		
	LEK	EUR	Totali
Aktivët financiarë			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	9,886,487	61,295,383	71,181,870
Investime në qira financiare		17,484,617	17,484,617
Hua dhe paradhënie, faktoring		24,557,316	24,557,316
Të tjera aktive	4,621,318		4,621,318
Totali	14,507,805	103,337,316	117,845,121
Detyrimet financiare			
Hua	13,803,188	54,232,862	68,036,050
Detyrime të tjera	933,683		933,683
Totali	14,736,871	54,232,862	68,969,733
Rreziku monedhës më 31 dhjetor 2016	(229,066)	49,104,454	48,875,388

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**28.5 Rreziku operacional**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rrjedh nga dështimet në sistemet, gabimet njerëzore, mashtrimi apo ngjarjet të jashtme. Kur kontrollet nuk funksionojnë, rreziqet operationale mund të shkaktojnë dëme të reputacionit, të sjellin pasoja ligjore ose rregullatore, ose të çojnë në humbje financiare. Shoqëria nuk pret të eliminojë të gjitha rreziqet operationale, por ajo përpiqet që të menaxhojë këto rreziqe nëpërmjet një kuadri kontrolli dhe duke monitoruar dhe ju përgjigjur rreziqeve të mundshme. Kontrollet përfshijnë ndarjen efektive të detyrave, aksesin, autorizimin dhe procedurat e rakordimeve, edukimin e stafit.

28.6 Administrimi i kapitalit

Shoqëria e administron kapitalin e saj duke siguruar vijimësinë e aktiviteteve të saj duke maksimizuar kthimin e ortakëve përmes optimizimit të tepriçës së borxhit dhe asaj të kapitalit të vet.

Në përputhje me Rregulloren Nr.2 të Bankës së Shqipërisë, datë 17.01.2013, "Për administrimin e rrezikut në subjektet financiare jo-banka", ekspozimi i subjektit që ushtron veprimtarinë e qirasë financiare ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 25% (njëzet e pesë për qind) e kapitalit të subjektit. Subjekti nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku, tejkalojnë 1200% (një mijë e dyqind) për qind të kapitalit të subjektit. Për sa më sipër aplikohet vetëm për qiranë financiare.

Në përputhje me të njëjtën rregullore, Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtëm:

a. raporti i kapitalit me totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më pak se 5% (pesë për qind) në vitin e parë të veprimtarisë, 8% (tetë për qind) në vitin e dytë dhe 10% (dhjetë për qind) në vazhdim;

b. raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c. raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Gjendja e kapitalit dhe raportit të borxhit të Crimson Finance Fund Albania më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huamarrje totale	207,987,296	68,036,050
Minus: Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	(130,973,910)	(71,181,870)
Detyrime neto	77,013,386	(3,145,820)
Totali i kapitalit të nënshkruar	54,739,760	54,739,760
Kapitali nënshkruar/detyrimeve neto	71%	-1740%

28. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

28.7 Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi vlerën e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë bazohet mbi instrumentat financiarë ekzistues të pasqyrës të pozicionit financiar, pa u përpjekur për të aktualizuar vlerën e bizneseve të ardhshme dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë instrumenta financiare.

Hua dhe paradhënie neto faktoring dhe investimet neto në qira financiare – Hua dhe paradhënie neto faktoring dhe investimet neto në qira financiare mbahen neto duke u zbritur humbjet për zhvlerësim. Portofoli i kredive të Crimson Finance Fund Albania ka një vlerë të drejtë të përllëgaritur për afërsisht sa vlera kontabël si pasojë e natyrës afat-shkurtër ose normave të interesit fikse gjatë jetës së kreditë. Këto norma i për afrohen normave të interesit të tregut.

Borxhi i varur – Norma e interesit të borxhit të varur është i ndryshueshëm dhe i për afrohen vlerës së tregut. Vlera e drejtë është për afërsisht e njëjtë me vlerën kontabël.

Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllimin e dhënies së shënimeve shpjeguese.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017			
	Hua dhe të arkëtueshme	Të tjera me koston e amortizuar	Totali i vlerës kontabel	Vlera e drejtë
Aktive monetare dhe ekuivalente me to		130,960,491	130,960,491	130,960,491
Investimi në qira financiare, neto	48,367,833		48,367,833	48,367,833
Hua dhe paradhënie	51,744,629		51,744,629	51,744,629
TVSH e arkëtueshme	10,208,498		10,208,498	10,208,498
Aktive të tjera	8,590,637		8,590,637	8,590,637
Borxh i varur		207,987,296	207,987,296	207,987,296
Detyrime të tjera		933,683	933,683	933,683
Detyrime ndaj klientëve		57,451	57,451	57,451

	31 dhjetor 2016			
	Hua dhe të arkëtueshme	Të tjera me koston e amortizuar	Totali i vlerës kontabel	Vlera e drejtë
Aktive monetare dhe ekuivalente me to		71,181,872	71,181,872	71,181,872
Investimi në qira financiare, neto	17,118,622		17,118,622	17,118,622
Hua dhe paradhënie	24,308,127		24,308,127	24,308,127
TVSH e arkëtueshme	4,233,016		4,233,016	4,233,016
Aktive të tjera	514,987		514,987	514,987
Borxh i varur		68,036,051	68,036,051	68,036,051
Detyrime të tjera		859,130	859,130	859,130
Detyrime ndaj klientëve		74,553	74,553	74,553

(Vlerat janë në Lek)

29. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara**Kolaterale**

Për sigurimin e qirave financiare edhe huave dhe paradhanieve faktoring, shoqëria merr kolaterale të cilat janë të paraqitura më poshtë, të ndara sipas llojit me vlerën kontraktuale.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pajisje dhe makineri	164,240,221	76,559,492
Prona të paluajtshme	20,694,250	19,677,000
Të tjera	1,703,500	1,703,500
	<u>186,637,971</u>	<u>97,939,992</u>

Detyrime për qiratë operative

Crimson Finance Fund Albania ka marrë me qira zyra në Tiranë. Angazhime e ardhshme të qirasë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Jo më shumë se një vit	2,911,143	2,961,060
1 -5 vjet	4,973,201	8,142,914
Mbi 5 vjet	-	-
	<u>7,884,344</u>	<u>11,103,974</u>

Angazhimet për qirate janë të anulueshme me një marrëveshje mirekuptimi midis Qiradhënësit dhe Qiramarrës për prishjen e kontratës. Paguesa e Qirase kryhet në monedhen Euro. Kursi i kombimit i përdorur për parashikimin e angazhimit në LEK më 31 dhjetor 2017 është EUR/ALL 132.95 (2016: EUR/ALL 135.23).

Angazhimet e dhëna për qiratë financiare

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Jo më shumë se një vit	29,183,312	10,138,554
Mes 1 -5 vjet	42,250,375	15,906,768
Mbi 5 vjet	-	-
	<u>71,433,687</u>	<u>26,045,322</u>

Angazhimet e dhëna për Faktoring

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Jo më shumë se një vit	54,848,656	30,726,575
Mes 1 -5 vjet	-	-
Mbi 5 vjet	-	-
	<u>54,848,656</u>	<u>30,726,575</u>

30. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.